



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/258

Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstraktet e Procesverbaleve dhe Transkripteve të mbledhjeve 251 dhe 254 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: 250, 252, 253, 255 dhe 256 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/258

Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, Prizren, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Ylber Elshani, kryesues;
 - 1.2. Agim Muçaj, anëtar;
 - 1.3. Selvete Xhigoli-Hyseni, anëtare;
 - 1.4. Sulejman Gashi, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi, kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat e tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat tri (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/258

Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, 50 dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, të nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa për huamarrje në vlerë 10,000,000.00€ (dhjetë milionë euro) për N P "Telekomi i Kosovës Sh. A.", subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.
2. Obligohet Thesari që për huadhënien ndaj ndërmarrjes publike të bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.
3. Mjetet e huadhënies sipas këtij Vendimi përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/258
Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafit 4, të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve në shumë prej 147,482.00€ (njëqind e dyzeteshtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro) në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me kod 221, nën programin "Administrata Qendrore" me kod 11321, nga kategoria e "Investimeve kapitale", konkretisht nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal", me kod 18782, në dy (2) projekte kapitale, në pajtim me Marrëveshjet dhe Aneks-marrëveshjet e Mirëkuptimit për projektet kapitale të nënshkruara nga Ministri i MZHR-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti kapital "Programi për Zhvillim Rajonal", me kod 18782, në këto projekte, me shumat e cekura si në vijim:
 - 2.1. "Parku i Aventurave" në Komunën e Kamenicës, në shumë prej 50,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 16170.
 - 2.2. "Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër", në Komunën e Novobërdës në shumë prej 97,482.00€, në kodin ekzistues të projektit 19535.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/258
Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit 2025-2026 për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, koordinon dhe monitoron zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/258
Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:


V E N D I M

Për themelimin e Grupit koordinues për Mishngrënësit e Mëdhenj (Ariun e murrmë/Ursus arctos, Rrëqebullin Ballkanik/Lynx Lynx si dhe Ujkun/Canis lupus)

1. Themelohet Grupi koordinues për Mishngrënësit e Mëdhenj (Ariun e murrmë/Ursus arctos, Rrëqebullin Ballkanik/Lynx Lynx si dhe Ujkun/Canis lupus), në këtë përbërje:
 - 1.1. Tahir Ahmeti, Departamenti i Pylltarisë, MBPZhR, kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Kabineti i Ministrit të MBPZhR, anëtar;
 - 1.3. Menderes Ibra, APK, anëtar;
 - 1.4. Sadik Heta, AUV, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, Kabineti i Ministrit të MMPHI-së, anëtar;
 - 1.6. Miradije Gërguri, DMMU, anëtare;
 - 1.7. Fadil Bajraktari, AMMK, anëtar;
 - 1.8. Evelina Ajazaj-Leka, FGJK, anëtare;
 - 1.9. Linda Grapci-Kotorri, FShMN, anëtare;
 - 1.10. Mirvjena Kellezi, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, anëtare;
 - 1.11. Krenare Salihu, Ecopana, anëtare;
 - 1.12. Afrim Mahmuti, Pylli i Arinjve, anëtar, dhe
 - 1.13. Fatos Lajqi, OJQ Era Grup, anëtar;
2. Grupi koordinues nga pika 1. e këtij Vendimi ka për detyrë të koordinojë aktivitetet në menaxhimin Mishngrënësit e Mëdhenj (Ariun e murrmë/Ursus arctos, Rrëqebullin Ballkanik/Lynx Lynx si dhe Ujkun/Canis lupus) të cilat bien në kategorinë e llojeve të kafshëve të egra të mbrojtura, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Vendimit nga pika 1. dhe 2. e këtij Vendimi alokohen nga kategoria ekonomike e "Mallrave dhe shërbimeve" në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
4. Vlera e parashikuar e shpenzimeve për zbatimin e këtij Vendimi është përllogaritur të jetë 22.000€ në vit (njëzet e dy mijë euro).
5. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/258
Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M


Për themelimin e Grupit Intervenues për Mishngrënësit e Mëdhenj (Ariun e murrinë/Ursus arctos, Rrëqebullin Ballkanik/Lynx Lynx si dhe Ujkun/Canis lupus)

1. Themelohet Grupi Intervenues për Mishngrënësit e Mëdhenj (Ariun e murrinë/Ursus arctos, Rrëqebullin Ballkanik/Lynx Lynx si dhe Ujkun/Canis lupus), në këtë përbërje:

- 1.1. Besim Zogaj/DQIP&GJJ, kryesues;
- 1.2. Naser Krasniqi/Departamenti i Pylltarisë, anëtar;
- 1.3. Qamil Feka, Departamenti i Infrastrukturës, anëtar;
- 1.4. Berat Hoxha, AUV, anëtar;
- 1.5. Bafti Murati, AUV, anëtar;
- 1.6. Ali Sefaj/AMMK, anëtar;
- 1.7. Naim Shala/APK Blinaja, anëtar;
- 1.8. Fitim Hoxhaj/APK, anëtar;
- 1.9. Yll Tigani/APK, anëtar;
- 1.10. Miloš Stojković/APK, anëtar;
- 1.11. Agron Shkodra/APK, anëtar;
- 1.12. Ardian Millaku/APK anëtar;
- 1.13. Neze Shala /PK Sharri, anëtare;
- 1.14. Fadil Alija /PK Bjeshkët e Nemuna, anëtar;
- 1.15. Bekim Bytyqi/PK Sharri, anëtar;
- 1.16. Selatin Mjeku/Klinika Veterinare, anëtar;
- 1.17. Kreshnik Rugova/Klinika Veterinare, anëtar;
- 1.18. Ajet Salihaj/FGJK, anëtar;
- 1.19. Agim Kabashi/FGJK, anëtar;
- 1.20. Skënder Sadikaj/FGJK, anëtar;
- 1.21. Bujar Berisha/Menaxher i vend gjuetisë, anëtar;
- 1.22. Gili Tafili/Menaxher i vend gjuetisë, anëtar;
- 1.23. Ismet Shala/Menaxher i vend gjuetisë, anëtar;
- 1.24. Asdren Doli/ShPPK, anëtar;
- 1.25. Ilir Veseli/Policia e Kosovës, anëtar;
- 1.26. Lendita Gashi/Policia e Kosovës, anëtare;
- 1.27. Albana Hoti/Pylli i Arinjve, anëtare;
- 1.28. Ilir Murtezi /Pylli i Arinjve, anëtar.

2. Grupi Intervenues nga pika 1. e këtij Vendimi, ka për detyrë të menaxhojë aktivitetet që kanë të bëjnë me trajtimin e kafshëve të egra të përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi si: Mishngrënësit e Mëdhenj (Ariun e murrme/Ursus arctos, Rrëqebullin Ballkanik/Lynx Lynx si dhe Ujkun/Canis lupus) të cilat bien në kategorinë e llojeve të kafshëve të egra të mbrojtura, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Vendimit nga pika 1. dhe 2. e këtij Vendimi alokohen nga kategoria ekonomike e "Mallrave dhe shërbimeve" në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
4. Vlera e parashikuar e shpenzimeve për zbatimin e këtij Vendimi është përlogaritur të jetë 22.000€ në vit (njëzet e dy mijë euro).
5. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/258

Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 119/A të Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-115, Ligjin Nr.05/L-080 dhe Ligjin Nr.06/L-023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në dy (2) ndërmarrje shoqërore, si në vijim:
 - 1.1. Në ndërmarrjen Shoqërore "NBI Suhareka", në shumë prej 651,360 € (gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë euro);
 - 1.2. Në ndërmarrjen Shoqërore "KB Malisheva", në shumë prej 72,622 € (shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzetë e dy euro).
2. Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimit të këtyre të hyrave dhe nga llogaria kryesore e BRK dhe kthehen në llogaritë e Ndërmarrjeve Shoqërore sipas pikës 1. të këtij Vendimi, me qëllim që Ndërmarrjet Shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat kreditore apo të për të mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/258
Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore për nevoja të Institucioneve Qendrore të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Zona Kadastrale Atmaxhë, Komuna Prizren dhe Zona Kadastrale Banjë, Komuna Malishevë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/258

Datë: 16.04.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për bartjen e së drejtës së shfrytëzimit dhe ndryshimin e shfrytëzuesit në ngastrat që ndodhen në Komunën e Junikut, Zona Kadastrale Junikut, në përputhje me mënyrën e shfrytëzimit, kohëzgjatjen dhe kompensimin e pyjeve dhe tokës pyjore ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, në njërën anë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në anën tjetër.
2. Përfitues i së drejtës së shfrytëzimit të ngastrave, me të dhënat e detajuara dhe të paraqitura në Shtojcën 1. të këtij Vendimi, është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht, Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale/ AMMKM.
3. Bartja e së drejtës së shfrytëzimit, sipas nenit 1. të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ndërtimit të Monumentit të Dëshmorëve të rënë me 17 Korrik 1998, të vendi "Rasa e Zogut" - bjeshkët e Junikut. Investimin e bën AMMKM/MKRS me procedurë të hapur konkurruese-tender, bazuar në kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.
4. Ngastrat me të dhënat e paraqitura në Shtojcën 1. të këtij Vendimi regjistrohen në pronësi të Republikës së Kosovës, shfrytëzues MKRS-Agjencia përgjegjëse-AMMKM.
5. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia e Pyjeve të Kosovës, në cilësinë e pronarit të pronës publike (pyje dhe tokë pyjore), si dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Sharrit" si administrues të pronës publike pyje dhe tokë pyjore brenda parkut, pezullon çdo procedurë për dhënie me qira apo në ndonjë formë tjetër të shfrytëzimit të ngastrave të identifikuara në Shtojcën 1. dhe Shtojcën 2. të këtij Vendimi.
6. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Sharrit" dhe Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit, respektivisht, Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale të ndërmarrin veprimet administrative të nevojshme për ekzekutimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

LISTA E PARCELAVE NË PRONËSI PUBLIKE PËR TË CILAT KËRKOHET E DREJTA E SHFRYTËZIMIT PËR 99 VITE

Komuna e Rahovecit

Parcela		Zona Kadastrale	Komuna	Pronari	Sipërfaqja
Nr.	nr.				
1	00016-0	Junik	Junik	P.SH.OPPB "KOSOVO DERVO PRISHTUTINË - OP GJERAVICA - DEÇAN	625.00

Shtojca II

LISTA E PARCELA NË PRONËSI PUBLIKE PËR TË APROVOHET NDËRRIMI I SHFRYTËZUESIT

Komuna e Rahovecit

Nr.	Parcela nr.	Zona Kadastrale	Komuna	Pronari	Sipërfaqja
1	00016-0	Junik	Junik	P.SH.OPPB "KOSOVO DERVO PRISHTUNË - OP GJERAVICA - DEÇAN	6 ari e 25 m ²



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/258
Datë: 16.04.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Shtetit të Izraelit.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/258
Datë: 16.04.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes Shoqërore "Kooperativa Bujqësore" Ropotovë e Madhe, Zona Kadastrale Dobërçan, që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, shpronësimi i të cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit: Varrezat e Fshatit dhe Fusha Sportive në Dobërçan, Zona Kadastrale: Dobërçan, Komuna Gjilan, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është Raporti i vlerësimit i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues-Komuna e Gjilanit, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, komfor legjislationit në fuqi.
8. Subjekti Kërkues-Komuna e Gjilanit, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/258
Datë: 16.04.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. "Industria e Tekstilit Integj" parcela kadastrale Nr. 4945-7 dhe Objekti që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e projektit: "Çerdhe e fëmijëve, hapësirë gjelbëruese dhe infrastrukturë rrugore" Zona Kadastrale: Gjilan, Komuna Gjilan, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është Raporti i vlerësimit i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues-Komuna e Gjilanit, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, komfor legjislationit në fuqi.
8. Subjekti Kërkues-Komuna e Gjilanit, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/258
Datë: 16.04.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit, 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N2 Segmenti "Hyrja në Qytetin e Ferizajt", Zonat Kadastrale: Prelez i Jerlive, Muhoc, Talinoc i Jerlive, Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj dhe Fshat i Vjetër, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislationit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë